



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 31.1.2025

Nr: 60

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË BANKËS SË SHQIPËRISË, PËR PERIUdhËN 19 JANAR – 25 JANAR 2025

Sot, më datë 31.1.2025 unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

SUBJEKT: Banka e Shqipërisë

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ i veprimtarive publike të Bankës së Shqipërisë për periudhën 19 janar deri më 25 janar 2025.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 19- 25 janar 2025, Banka e Shqipërisë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve (NRI), 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon.

- Në datën 23.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 23.1.2025, ora 09.00, me tematikë, “Tjetër”, “Ekonomi”, “workshop teknik mbi “Aspektet teknike dhe ligjore të anëtarësimit në SEPA. Workshopi është zhvilluar në praninë e përfaqësuesve të sistemit bankar dhe institucioneve financiare, pa media. Në media do të publikohet fjala e Zëvendesguvernatores së Bankës së Shqipërisë, zj. Luljeta Minxhozi.

Data: 31.1.2025 Nr: 60
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Bankës së Shqipërisë për periudhën 19 janar – 25 janar 2025”

Nëpërmjet email-it, administrata e KQZ-së i ka kërkuar Bankës e Shqipërisë, një informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkëljes, ose t'i paraqesë ato në seancën publike të datës 31.1.2025, ora 12:00.

Pas njoftimit të kryer, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Bankës së Shqipërisë ka dërguar pretendimet, duke sqaruar se: *“Në moment të fundit është vendosur të publikohet fjala përshëndetëse që ka mbajtur Zëvendësguvernatorja në hapje të këtij workshopi, si një thirrje e shtuar për t'i nxitur institucionet financiare për operacionalizimin e anëtarësimit të Shqipërisë në SEPA.*

Aktiviteti ishte i natyrës tërësisht teknike, si në përmbajtje ashtu edhe pjesëmarrësit, pa media, drejtuar kryesisht institucioneve financiare për mënyrën si të veprojnë për anëtarësimin në SEPA.

Për sa më sipër, referuar të dhënave të aktivitetit të paraqitura në ndërfaqen e raportimeve si dhe pretendimeve të dhëna nga personi përgjegjës për raportim, vlerësoj se veprimtaria e raportuar nga Banka e Shqipërisë përbën një veprimtari administrative që lidhet me veprimtarinë funksionale të institucionit dhe si e tillë nuk mbart detyrimin për t'u raportuar. Rezulton se veprimtaria nuk ka qenë e hapur për publikun dhe nuk ka pasur pjesëmarrje të medias.

Në përfundim të shqyrtimit, pasi u njoha me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerësoj se veprimtaria e raportuar nga Banka e Shqipërisë përbën një veprimtari administrative që lidhet me veprimtarinë funksionale të institucionit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj Bankës së Shqipërisë.
2. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI